



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13471 Prot

Lezhë, më 29 / 07 /2022

VENDIM

Nr. 87, Datë 28 . 07 .2022

**Për përdorimin e fondit të emergjencës për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”; ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 223,200 lekë për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familjenë fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi banesat e tyre janë bërë të pabanueshme si shkak i rrëshqitjes së dherave.

Për këtë të kryhen veprimet në programin buxhetor Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.606 për shumën 223,200 lekë.

2.Mbulimi i qirasë së banesave do të jetë për periudhën 01.07.2022 - 31.12.2022.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

10r-136411/prot  
DA-08-08-2022

Nr. 549/10 Prot.

Lezhë, më 05.08.2022

**Lënda : Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Lezhë**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

**Lezhë**

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma “b”, në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 13, pika 2, neni 15, neni 16, neni 24, pika 2, neni 54, neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 13, pika 1 (i), në ligjin nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfutur strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr.87, datë 28.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për përdorimin e fondit të emergjences për mbulimin e shpenzimeve të strehimit (qirasë së banesave) për 4 familje në fshatin Sukaxhi, Njësia Administrative Ungrej, pasi kanë dalë të pastreha si shkak i dëmtimit të banesave nga rrëshqitja e dherave”.

